

Hapet thirrja për stafin akademik me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës në kuadër të programit Erasmus + në Universitetin Alexandru Ioan Cuza të Iași, në Rumani

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për stafin akademik me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës në Universitetin Alexandru Ioan Cuza të Iași, në Rumani për semestrin e parë të vitit akademik 2019-2020.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie;

Kohëzgjatja e bursave:

- Shkëmbimi i stafit akademik për mësimdhënie (5 + 2 ditë);

Fushat e studimit:

- Histori dhe arkeologji;
- Filozofi dhe etikë;
- Edukim;
- Gjuhë të huaja;
- Shkenca sociale dhe të sjelljes (shkenca politike, sociologji, dhe studime kulturore, psikologji);
- Gazetari dhe raportim;
- Biznes dhe administrim (menaxhim dhe administrim, kontabilitet, financë, ekonomiks, marketing);
- Drejtësi;
- Shkenca të Biologjisë (biologji, biokimi);
- Shkenca të fizikës (kimi, fizikë, shkencat e tokës);
- Matematikë dhe statistikë;
- Teknologji informacioni dhe Komunikimi;

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin ditor (140 EUR në ditë për stafin);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni link-ut:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin akademik me kohë të plotë për mësimdhënie:

- CV+ Lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe dhe angleze);
- Certifikata e gjuhës së huaj (B2);
- Vetëdeklarim nëse keni kryer më parë një mobilitet Erasmus+ dhe nëse po, ku;
- Letër ftese nga Universiteti pritës, sipas formatit bashkëngjitur, duke dërguar paraprakisht një CV dhe një përshkrim të shkurtër të propozimit tuaj të mësimdhënies;

https://erasmusplus.uaic.ro/docs/Erasmus_faculty_coordinators.zip

- Plani i mobilitetit për mësimdhënie*;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Mësimdhënie klikoni në adresën:

http://www.unitir.edu.al/images/Mobility_Agreement_Teaching_outgoing.docx

*Plani i Mobilitetit për stafin akademik është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat, i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +.

Afati për aplikim: 20 Qershor 2019

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikim!